



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1457/13prot

Datë 18.06.2026

V E N D I M

Nr. 831/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro
Anila Malaj
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Anëtar
Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.06.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 779/2026, datë 10.06.2026 për procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr. REF-79524-03-18-2026, me objekt: “*Shërbimi i mirëmbajtjes së sistemeve të integruara të sigurisë (sisteme CCTV, alarmi, GPS/GPRS, sisteme vëzhgimi auto) dhe platformës së monitorimit të Posta Shqiptare sh.a*”, me fond limit 39,326,900 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 21.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare sh.a.

Ankimues:

BOE “Eurogjici-Security” SHPK & “Instant.AI” SHPK përkatësisht me NUIS K31929010K e L81506043D dhe adresë: Rruga Adem Jashari, Lagjia nr 8, Ndertesa 4, Hyrja 10, Ap 3, Njesia Bashkiake nr 5, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Posta Shqiptare sh.a, me adresë: Rr. “Reshit Çolloku”, Nr. 4 Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë

13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 10.06.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.779/2026, ku vendosi:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së BOE “Eurogjici-Security” SHPK & “Instant.AI” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr. REF-79524-03-18-2026, me objekt: *“Shërbimi i mirëmbajtjes së sistemeve të integruara të sigurisë (sisteme CCTV, alarmi, GPS/GPRS, sisteme vëzhgimi auto) dhe platformës së monitorimit të Posta Shqiptare sh.a”*, me fond limit 39,326,900 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 21.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare sh.a.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga BOE “Eurogjici-Security” SHPK & “Instant.AI” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit. “
3. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të BOE “Eurogjici-Security” SHPK & “Instant.AI” SHPK në SPE në përputhje me konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik në këtë vendim.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Eurogjici-Security” SHPK & “Instant.AI” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.612/12 prot., datë 12.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1457/10 prot., datë 15.06.2026, autoriteti kontraktor Posta Shqiptare sh.a informon KPP-në se ka zbatuar Vendimin Nr. 779/2026, datë 10.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr.612/12 prot., datë 12.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1457/10 prot., datë 15.06.2026, autoriteti kontraktor Posta Shqiptare sh.a informon KPP-në se ka zbatuar Vendimin Nr. 779/2026, datë 10.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik, bëri verifikimet përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik, lidhur me zbatimin e vendimit Nr. 779/2026, datë 10.06.2026 të KPP-së. Nga ky verifikim, rezultoi se, autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr. 779/2026, datë 10.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e mësipërme të prokurimit, në përputhje me arsyetimet e konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik në këtë vendim.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; nenit 46 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”; Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit *E hapur*, me nr. REF-79524-03-18-2026, me objekt: “*Shërbimi i mirëmbajtjes së sistemeve të integruara të sigurisë (sisteme CCTV, alarmi, GPS/GPRS, sisteme vëzhgimi auto) dhe platformës së monitorimit të Posta Shqiptare sh.a*”, me fond limit 39,326,900 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 21.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare sh.a.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

